



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

DREJTORIA TEKNIKE

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)**

Operatorit Ekonomik “GERTI – 1987” SHPK

Adresa: Gjirokaster Permet Fshati Çarshove, Objekt me nr. pasurie 47/435, Zona Kadastrale 1356

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar** marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues).

Numri i procedurës/referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti IV: **“Blerje ushqime koloniale”**, me Nr.**REF-13050-07-12-2024** për nevoja të Autoriteteve Kontraktore përfituese Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër dhe Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: Deri në 24 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër. Lëvrimi/dorëzimi i mallit për lotin e katërt do të bëhet nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoriteteve kontraktore, në bazë të marrëveshjes kuadër.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini Nr. 40 datë 22 Korrik 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

• **Operatori ekonomik “Gentjan Kadriu” pf**

NUIS K81630012E

Vlera e ofertës pa tvsh = **8,378,610** (*tetë milion e treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dhjetë*) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “M.C.CATERING” sh.p.k** **NUIS J71601012S**

Vlera e ofertës pa tvsh = **8,596,230** (*tetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë*) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “3 – SH” shpk** **NUIS K62721401R**

Vlera e ofertës pa tvsh = **7,474,179** (*shtatë milion e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë*) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “GERTI - 1987” shpk** **NUIS L27606201D**

Vlera e ofertës pa tvsh = **9,320,110** (*nëntë milion e treqind e njëzet mijë e njëqind e dhjetë*) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- **Operatori ekonomik “Gentjan Kadriu” pf** **NUIS K81630012E**

Për arsyet e mëposhtme:

1. Në tabelën e paraqitur sipas pikës 7 e Kapacitetit Teknik të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, për artikujt objekt prokurimi, operatori ekonomik ka deklaruar kontratë furnizimi me subjektin “MYZYRI-F” sh.p.k si prodhues ose distributor i autorizuar nga prodhuesi. Në vijim KVO verifikoi në Regjistrin Kombëtar të Licensave, QKL on-line nga ku “MYZYRI-F” sh.p.k rezulton të ketë vetëm liçencën me nr. LN-6744-02-2019 “*Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerez)*”.

Si rrjedhim subjekti “MYZYRI-F” nuk është prodhues i artikujve ushqimorë.

2. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 1 e Kapacitetit Teknik të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi ka paraqitur dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme vetëm fatura tatimore shitjeje me produktin “jufka”. Gjithashtu nga verifikimi në Regjistrin Kombëtar të Licensave, QKL on-line, “Gentjan Kadriu” rezulton me liçencë nr. LN-7924-05-2014 “*Prodhim, përpunim, ambalazhim, etiketim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (makarona)*” .

2. **Operatori ekonomik “M.C.CATERING” sh.p.k** **NUIS J71601012S**

Për arsyet e mëposhtme:

Në tabelën e paraqitur sipas pikës 7 e Kapacitetit Teknik të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, për artikujt objekt prokurimi, operatori ekonomik ka deklaruar kontratë furnizimi me subjektin

“FM MARTINI” sh.p.k si prodhues ose distributor i autorizuar nga prodhuesi. Si rrjedhim KVO verifikoi në Regjistrin Kombëtar të Licensave, QKL on-line nga ku “FM MARTINI” sh.p.k rezulton pa asnjë liçencë, si rrjedhojë për këtë subjekt nuk vërtetohen të drejtat ligjore në lidhje me “Prodhimin përpunim dhe shpërndarjen me shumicë të ushqimeve për njerez”.

- **Operatori ekonomik “3 – SH” shpk**

NUIS K62721401R

Për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit Teknik të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi për atikujt nr. 12 (**Nishte cilësi e parë**), nr. 13 (**Maja buke e presuar, cilësi e parë**), nr. 31.1 (**Uthull rrushi**), nr. 40 (**Thjerrëz**), nr. 42 (**Sodë buke, cilësi e parë**), nr. 46 (**Trahana, cilësi e parë**), nr. 47 (**Çaj mali, cilësi e parë**), nr. 58 (**Kafe turke cilësi e parë**), nr. 71 (**Peta të thata**), sipas shtojcës 6 të DST, nuk ka deklaruar nëse është prodhues si dhe nuk ka paraqitur kontratë furnizimi me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi.

Sic përcaktohet edhe në DST:

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

*Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false **dhe të pasakta**, konsiderohen kushte për skualifikim*

Për këtë arsye, dokumenti i paraqitur nga O.E është i pasaktë dhe përbën kusht për s’kualifikim.

Duke iu referuar procedurës së mësipërme meqënëse procedura është marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, **ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues** ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm i identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit është:

- **Operatori ekonomik “GERTI - 1987” sh.p.k**

NUIS L27606201D

Vlera e ofertës pa tvsh = **9,320,110** (nëntë milion e treqind e njëzet mijë e njëqind e dhjetë) lekë pa TVSH.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.